



PARTIA DREJTËSI, INTEGRIM DHE UNITET
JUSTICE, INTEGRATION AND UNITY PARTY

Rruga Myslym Shyri, Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, TIRANA, ALBANIA,
E-mail: info@pdu.al

K Q Z
U PROTOKOLLUA
NR. 166 PROT
DATE 3.3.2021

Nr. Prot. 44

Tiranë më: 02.03.2021

Lënda: Pasqyrat Financiare të periudhës ushtrimore 2020

Drejtuar: KOMISIONIT QËNDROR TË ZGJEDHJEVE T I R A N Ë

Bazuar në vendimin tuaj nr 3 datë 18.01.2011, bashkëngjitur po ju dërgojme pasqyrat financiare të periudhës ushtrimore 2020.

Shënimet shpjeguese të Pasqyrave Financiare të periudhës ushtrimore 2020.

Organizimi, Kontributet (Burimet), Kapitali dhe Administrimi

Organizimi Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet (PDIU) është themeluar me datë 11.03.2011, si një bashkim vullnetar të shtetasve mbi bazën e ideve, të bindjeve e të pikëpamjeve ose të interesave të përbashkëta politike, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesëmarrjes në zgjedhjet dhe përfaqësimit të popullit në organet e zgjedhura të pushtetit.

Veprimtaria e Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet, rregullohet sipas Ligjit nr. 8580 date 17.02.2000 "Per Partite Politike" ndryshuar me ligjin nr. 10374 date 10.02.2011, legjislacioni përkatës në fuqi dhe nga Statuti i saj.

STRUKTURA e Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet:

Numri i anëtarësisë së e Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet është: 24 000 anëtarë.

A. ORGANET QENDRORE. - a. Kongresi i Partisë - b. Këshilli Kombëtar i Partisë. - c. Kryesia - d. Kryetari - e. Sekretari i Përgjithshëm - f. Sekretariatet – g. Departamentet.

B. ORGANET VENDORE Seksioni, (në nivel qendre votimi), - Nëndega (disa seksione), - Konferenca e Nëndegës, - Kryesia e Nëndegës, - Kryetari i Nëndegës, - Dega e Partisë, Konferenca e Degës, - Kryesia e Degës, - Kryetari i Degës, - Nënkryetarët, Sekretarët e Degës, Këshilli Politik i Qarkut, Koordinatorët e Qarkut, - Organizimi i PDIU për Tiranën.

Burimet e Financimit: Nga buxheti i shtetit, kuotat e anëtarësisë dhe kontribute.

Me respekt

Kryetari i PDIU

Shpirtim IDRIZI





PARTIA DREJTESI, INTEGRIM DHE UNITET

Rruga "Myslym Shyri", Postë e qerdhes nr.47, Tiranë

PASQYRAT FINANCIARE 2020

(Mbyllur më 31.12.2020)

Periudha kontabël: Nga 01.01.2020 deri më 31.12.2020

Tiranë, Shkurt 2021



TABELA E PERMBAJTJES

A. PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	3
B. PASQYRA E AKTIVITETEVE	4
C. PASQYRA E FLUKSIT TE MJETEVEONETARE	5
D. SHENIME PER PASQYRAT FINANCIARE	6 - 13



PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR

PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2020

(Të gjitha shumat janë në monedhën Lekë, përveç kur shprehen ndryshe)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2020	Viti Paraardhës 31.12.2019
I	AKTIVET			
1	Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	5	21,522,371	22,099,419
2	Të drejta dhe interesi i arkëtueshëm		-	-
3	Kontribute të arkëtueshme Inventarë dhe shpenzime të 4 parapaguara		-	-
5	Investime financiare afat gjata Aktive të kufizuara për investime në 6 toka, ndërtesa dhe pajisje		-	-
7	Toka, ndërtesa dhe pajisje	6	3,269,181	3,771,609
8	Investime të tjera afatgjata		-	-
	Totali i aktiveve (I)		24,791,552	25,871,028
II	DETYRIMET			
1	Të pagueshme	7	957,165	1,371,479
2	Dëftesa të pagueshme		-	-
3	Kontribute të marra në avancë		-	-
4	Grante		-	-
5	Premtime të kushtëzuara për të dhënë		-	-
6	Hua afat gjatë		-	-
	Totali i detyrimeve (II)		957,165	1,374,479
III	AKTIVET NETO			
1	Të kufizuara Tokë ose vepra arti të dhuruara për t'u përdorur për qëllime specifike me përcaktimin që të ruhen apo të mos shiten. Aktive të dhuruara me qëllimin për t'u investuar dhe siguruar prej tyre burime të përhershme të ardhurash		-	-
2	Të pakufizuara		23,834,387	24,496,549
	Totali i aktiveve neto (III)	10	23,834,387	24,496,549
	TOTALI AKTIVIT NETO DHE DETYRIMEVE		24,791,552	25,871,028

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



PASQYRA E AKTIVITETEVE (PERFORMANCËS)
 PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2020
 (Të gjitha shumat janë në monedhën Lekë, përveç kur shprehen ndryshe)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2020	Viti Paraardhës 31.12.2019
A Ndryshimi në aktivet neto të pakufizuara :				
Të ardhurat :				
	Të ardhura nga tarifat e antarësimit		1,885,722	1,959,600
	Të ardhura nga donacionet dhe kontrib. vullnetare		-	-
	Të ardhura nga grantet, qeveritare, agjenci të tjera		7,447,475	10,107,290
	Të ardhura nga investimet apo dhurimet		-	-
	Tarifat për shërbimet		-	-
	Të ardhura nga aktivitetet tregtare		-	-
	Të ardhura të tjera		-	-
	Totali i të ardhurave		9,333,197	12,066,890
Aktive neto të çliruara nga kufizimet:				
	Realizimi i kufizimeve të programit		-	-
	Realizimi i kufizimit për blerjen e pajisjeve		-	-
	Përfundimi i kufizimit të afatit		-	-
	Totali i aktiveve neto të çliruara nga kufizimet		-	-
	Totali i të ardhurave nga aktivet neto të pakufizuara:		9,333,197	12,066,890
Shpenzime për aktivitetet				
	Aktiviteti-Fushata zgjedhore		-	-
	Shpenzime administrimi e të tjera të përgjithshme		(9,995,359)	(8,517,189)
	Krijim dhe rritje fondesh (Sistemim)		-	-
	Totali i shpenzimeve		(9,995,359)	(8,517,189)
	Rritja / Rënia në aktivet neto të pakufizuara (A)		(662,162)	3,549,701
B Ndryshimi në aktivet neto të kufizuara :				
	Kontributet		-	-
	Të ardhurat nga investimet afat gjata		-	-
	Fitimi i realizuar dhe i porealizuar nga invest. afatgjata		-	-
	Humbja aktuariale nga obligacioni vjetor		-	-
	Aktivitet neto të çliruara nga kufizimet (minus)		-	-
	Rritja / Rënia në aktivet neto përkoh. të kufizuara (B)		-	-
C Ndryshimi në aktivet neto (A + B)				
	10		(662,162)	3,549,701
	Aktive neto në fillim të vitit		24,496,549	20,946,848
	Aktive neto në fund të vitit		23,834,387	24,496,549

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.



PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

PER VITIN E MBYLLUR ME 31 DHJETOR 2020

(Të gjitha shumat janë në monedhën Lekë, përveç kur shprehen ndryshe)

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Shënime	Viti Raportues 31.12.2020	Viti Paraardhës 31.12.2019
I	AKTIVITETET E SHFRYTËZIMIT			
	NDRYSHIMET NE AKTIVET NETO		(662,162)	3,549,701
	Rregullimet për përputhjen e ndrysh. në aktivet neto me flukset neto nga aktivitetet:			
	Amortizimi dhe zhvlerësimi		502,429	582,023
	Humbjet e realizuara dhe të parealizuara në investime			
	Humbjet nga dalja jashtë përdor. e makineri pajisjeve		-	-
	Kontributet jo në para		-	-
	Rritjet/ Rënit jo në para të inventarëve		-	-
	Kontributet e kufizuara për invest.në dhurime/ ndihma		-	-
	Ndryshimet në aktivet dhe detyrimet afatshkurtra:			
	Të tjera të arkëtueshme		-	-
	Bamirësi në mirëbesim të arkëtueshme			
	Të pagueshme		(417,315)	458,477
	Bamirësi mbi baza vjetore			
	Flukse neto nga aktivitetet e shfrytëzimit		(577,048)	4,590,201
II	AKTIVITETET INVESTUESE			
	Blerje / Shitje investimesh		-	-
	Blerje / Shitje e Aktiveve afatgjata		-	(135,014)
	Principal i arkëtuar nga dëftesat e arkëtueshme		-	-
	Të arkëtuara në avancë nga dëftesa të arkëtueshme		-	-
	Flukse neto nga aktivitetet investuese		-	(135,014)
III	AKTIVITETET FINANCUERE			
	Principal i paguar për dëftesat e pagueshme			
	Flukse neto nga aktivitetet financuese		-	-
IV	Rritje/Rënie neto e mjeteve monetare (I+II+III)		(577,048)	4,455,187
	Mjete monetare dhe ekuivalentë, në fillim të periudhës		22,099,419	17,644,232
	Mjete monetare dhe ekuivalentë, në fund të periudhës		21,522,371	22,099,419
	Mjete monet. të paguara gjatë periudh. për interesa		-	-
	Mjete monet. të paguara gjatë periudh. për tatim taksa		-	-

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Këto pasqyra financiare janë aprovuar dhe janë firmosur nga:


Kryetari i Partisë
Shpëtim Idrizi

Shpëtim Idrizi



Hartuesi
Ermira Lulo

Ermira Lulo



SHËNIME PËR PASQYRAT FINANCIARE

PËR VITIN E MBYLLUR MË 31 DHJETOR 2020

(Të gjitha shumat janë në monedhën Lekë, përveç kur shprehen ndryshe)

1. INFORMACIONE TE PERGJITHSHME

Partia Drejtësi, Integrim dhe Unitet, është themeluar me 11 Mars 2011 dhe vepron në përputhje me ligjin nr.8580 date 17.02.2000 "Për Partite Politike", i ndryshuar, statutin i saj dhe kuadrin ligjor shqiptar.

Ajo është një organizim politik i qytetarëve të grupuar me vullnet të lirë mbi bazën e ideve, bindjeve dhe interesave politike, me struktura të organizuara mbi bazën e ndarjes territoriale, të cilët synojnë të ndikojnë në jetën e vendit nëpërmjet pjesmarrjes në zgjedhje dhe përfaqësimit në organet e pushtetit.

Burimet financiare të Partisë përbëhen nga kuotizacionet e anëtarësisë, nga granti që jep buxheti i shtetit sipas ligjit, nga ndihma e dhurata publike që njeh ligji për partitë politike, si dhe nga çdo burim tjetër të lejuar nga legjislacioni në fuqi.

Veprimtaria ekonomike e partisë administrohet nga Kryetari i Partisë, i cili kontrollon përdorimin e burimeve financiare në funksion të aktiviteteve dhe qëllimeve të partisë, si dhe shqyrton raportet financiare para dorëzimit të tyre në organet kompetente shtetërore dhe të partisë.

2. DEKLARATE E PAJTUESHMERISE ME SKK-TË PER OJF-TË

Pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqiten në përputhje me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit për Organizatat jo Fitimprurese (SKK për OJF-të), dhe me kërkesat e ligjit "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare".

3. BAZAT E MATJES TE PERDORURA

Pasqyrat financiare, përveç informacionit të flukseve të mjeteve monetare, janë përgatitur duke përdorur bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara të kontabilitetit. Mbi bazën e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara, elementët njihen si aktive, detyrime, aktive neto, të ardhura apo shpenzime kur ato plotësojnë përkufizimet dhe kriteret e njohjes për këto zëra.

Për matjen e vlerave monetare të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve, në pasqyrat e saj financiare, partia ka zgjedhur si bazë matjeje kosto historike dhe në raste të veçanta baza të tjera matjeje të lejuara nga standardet.

Paraqitja e tyre është bërë në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").



4. PERMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABEL ME TE RENDESISHME PER KUPTIMIN E PASQYRAVE FINANCIARE

4.1 Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare përfshijnë, mjete monetare në arkë dhe bankë, llogari rrjedhëse, si dhe, investime në tregun e parasë dhe tregje të tjera shumë likuide me kontrata jo më të gjata se tre muaj, të cilat janë objekt i një rreziku jo domethënës të ndryshimeve në vlerë.

Flukset monetare janë hyrjet ose daljet e mjeteve monetare dhe ekuivalentët e mjeteve monetare për veprimtari të shfrytëzimit, aktivitet investuese ose financuese.

4.2 Të drejta të arkëtueshme dhe të pagueshme

Matja fillestare e të arketueshmeve dhe pagueshmeve bëhet me vlerën e drejtë dhe më pas njihen me koston e amortizuar, duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provizionet për zhvlerësim. Interesi mbi të arketueshmet e pakthyera njihet mbi bazën e kontabilitetit të të drejtave të konstatuara.

4.3 Inventarët

Inventarët njihen, në përputhje me përcaktimet e bëra në SKK 04 - Inventarët, kur subjekti i kontrollon apo zotëron ato ekonomikisht apo ligjërisht, dhe kur kostoja matet në mënyrë të besueshme. Njohja e inventarëve bëhet zakonisht në momentin e përfitimit. Vlerësimi i mëpasshëm, pas njohjes fillestare, matet me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me koston për t'u përfunduar dhe shitur.

4.4 Toka, ndërtesa, pajisje

Aktivitet afatgjatë materiale (AAM-të) njihen si një aktiv vetëm nëse: aktivi kontrollohet nga partia, është e mundur që përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi i aktivitet të hyrë dhe kostoja e aktivitet mund të matet me besueshmëri. Regjistrimi fillestar i AAM-së bëhet zakonisht në momentin e përfitimit të tij nga blerja apo prodhimi dhe matet me kosto.

Në pasqyrën e pozicionit financiar një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen koston së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-ve dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar. Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

Amortizimi llogaritet mbi bazën e metodës së vlerës së mbetur për të gjitha vitet e jetës ekonomike të aktivitet, me norma vjetore, ndërtesat 5% dhe të tjerat 15%, 20%.



4.5 Të ardhura dhe shpenzime

Të ardhurat përfaqësojnë flukse hyrëse, gjatë periudhës së raportimit, të përfitimeve ekonomike apo formave të tjera të mundshme të përfitimeve, që rezultojnë në rritjen e aktiveve neto të pakufizuara.

Shpenzimet janë flukse dalëse, gjatë periudhës raportuese, të përfitimeve ekonomike apo formave të tjera të mundshme të përfitimeve, që rezultojnë në pakësimin e aktiveve neto të pakufizuara.

Kontributet e marra njihen si të ardhura ose fitime në periudhën kur merren dhe si aktive, pakësim të detyrimeve apo shpenzimeve në varësi të formës së përfitimit të marrë. Kontributet e marra maten me vlerën e tyre të drejtë. Kontributet e marra paraqiten si ndihma të kufizuara ose të pakufizuara. Kur merr kontribute në shërbime partia i përshkruan ato në programet apo aktivitetet për të cilat janë përdorur këto shërbime, përfshirë natyrën dhe shkallën e kontributit për periudhën si dhe shumën e njohur si të ardhur për periudhën.

Kontributet e dhëna do të njihen si shpenzime në periudhën kur janë dhënë dhe si pakësim i aktiveve apo shtim i detyrimeve, në varësi kjo të formës së përfitimit të dhënë. Kontributet e dhëna maten me vlerën e drejtë të aktivitetit të dhënë ose, nëse janë në formën e shuarjes së një detyrimi të përfituesit të donacionit, do të maten me vlerën e drejtë të detyrimit.

4.6 Transaksionet me monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj, që plotësojnë kushtet në njohje, regjistrohet në monedhën funksionale, duke zbatuar mbi shumën e monedhës së huaj kursin e menjëhershëm të këmbimit (spot). Në fund të çdo periudhe raportuese, zërat në monedhë të huaj përkthehen si më poshtë: zërat monetarë të shprehur në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit të mbylljes (d.m.th. në datën raportuese); zërat jomonetarë që maten me kosto historike në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën e transaksionit; zërat jomonetarë që maten me vlerën e drejtë në monedhë të huaj duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat e këmbimit, që krijohen gjatë shlyerjes së zërave monetarë ose gjatë përkthimit të zërave monetare me kurse këmbimi të ndryshme nga kurset e këmbimit, me të cilat ato janë përkthyer në njohjen gjatë periudhës kontabël aktuale, ose në pasqyrat financiare të mëparshme, njihen si fitim (ose humbje) të periudhës kontabël kur ato lindin. Kurset e këmbimit, të përdorura për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2020 janë 1 Euro = 123.70 Lekë dhe 1 Dollar = 100.84 Lekë.

4.7 Aktive neto

Aktivi neto është diferenca mes aktiveve dhe detyrimeve në datën e pasqyrës së pozicionit financiar. Aktivitet neto, mbështetur në ekzistencën ose mungesën e një kufizimi të vendosur



nga donatori, ndahen në: aktive neto të kufizuara, dhe aktive neto të pakufizuara sipas përcaktimeve të standardit kontabël për OJF-të. Ndryshimi në aktivet neto rezulton nga diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve të aktivitetit për periudhën.

INFORMACION MBESHTETES PER ZERAT E PARAQITUR NE PASQYRAT FINANCIARE, NE RENDIN NE TE CILIN PARAQITEN NE CDO PASQYRE DHE ZE PERKATES

5. Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Gjendjet e mjeteve monetare në bankë dhe arkë, në fillim dhe fund të ushtrimit janë si më poshtë:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2020	Viti Paraardhës 31.12.2019
1	Mjete Monetare ne Arke	3,898,632	2,485,226
2	Mjete Monetare ne Banke	17,623,739	19,614,193
3	Investime në Tregje shume Likuide	-	-
Totali		21,522,371	22,099,419

Gjendjet e llogarive të likuiditeteve të paraqitura në pasqyrat financiare konfirmohen me nxjerrjet e llogarive bankare dhe inventarët fizikë të monedhave në fund të ushtrimit.

Tepricat e shprehura në monedhë të huaj janë përkthyer në Lekë duke përdorur kursin e këmbimit të shpallur nga Banka e Shqipërisë.

Ndërsa të analizuara sipas bankave, llogarive bankare dhe monedhës funksionale ato paraqiten si vijon:

Nr	Llogaritë bankare	Viti Raportues 31.12.2020	Viti Raportues 31.12.2019
1	Banka Kombëtare Tregtare (BKT), Nr. 411445169CLTJCLALLGH	16,325,705	17,106,234
2	Credins Bank sh.a, Nr. 00000886391	1,298,034	2,507,959
Shuma e bankave		17,623,739	19,614,193

6. Toka, ndërtesa dhe pajisje

Vlera neto kontabël në fillim dhe në fund të vitit ushtrimor për aktivet afatgjata materiale (AAM-të) paraqiten si vijon:



Nr	Gjendjet dhe Lëvizjet	Toka/T errene	Ndërti me	Mjete transporti	Të tjera aktive afatëgjata	Parapagime për Aktive Materiale dhe në Proces	Totali
A	Kosto e AAM-ve 01.01.2020	-	-	2,947,477	1,406,155	-	4,353,632
	Shtesat	-	-	-	-	-	-
	Pakësimet	-	-	-	-	-	-
	Kosto e AAM-ve 31.12.2020	-	-	2,947,477	1,406,155	-	4,353,632
B	Amortizimi AAM-ve 01.01.2020	-	-	(442,122)	(139,901)	-	(582,023)
	Amortizimi ushtrimit	-	-	(375,803)	(126,625)	-	(502,429)
	Amortizimi për daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-	-
	Amortizimi AAM-ve 31.12.2020	-	-	(817,925)	(266,526)	-	(1,084,452)
C	Zhvlërimi AAM-ve 01.01.2020	-	-	-	-	-	-
	Shtesat	-	-	-	-	-	-
	Pakesimet	-	-	-	-	-	-
	Zhvlërësimi AAM-ve 31.12.2020	-	-	-	-	-	-
D	Vlera neto e AAM-ve 01.01.2020	-	-	2,505,355	1,266,254	-	3,771,609
E	Vlera neto e AAM-ve 31.12.2020	-	-	2,129,552	1,139,629	-	3,269,181

Si politikë kontabël për ndjekjen e AAM-ve, partia ka zgjedhur modelin e koston (SKK-5). Vlerësimi fillestar në momentin e hyrjes së AAM-ve është bërë me kosto dhe në datën e mbylljes së PF-ve paraqiten me koston e tyre minus zhvlërësimin e akumuluar dhe ndonjë humbje nga rënia e vlerës.

Gjatë ushtrimit ato nuk janë shtuar nga blerjet e aktiveve, por janë pakësuar me vlerën e amortizimit për shumën 502.429 lekë, llogaritur sipas politikave kontabël. Drejtimi nuk ka llogaritur rënie të vlerës për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2020.

7. Të pagueshme

Detyrimet afatshkurtra në fillim dhe në fund të ushtrimit kontabël paraqiten në tabelën vijuese:

NR	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2020	Viti Paraardhës 31.12.2019
1	Furnitorë për mallra e shërbime		
	Top Chanell	328,800	328,800
	OSHEE	35,985	45,544



	AlbTelecom	5,800	5,800
	UKT Tiranë	8,400	3,710
	Fruro Mania	-	3,000
	Coffe Club	7,000	6,000
	Qafshatama	13,780	12,780
	Alba Tech System	-	66,800
	Univers Reklama	58,972	66,800
2	Të pagueshme ndaj punonjësve	-	340,790
3	Sigurime shoqërore dhe shëndetësore	210,538	137,389
4	Të tjera	287,890	423,866
	Shuma	957,165	1,374,479

Të pagueshme ndaj furnitorëve pasqyron detyrimet nga blerja e mallrave dhe shërbimeve të mbetura pa u likjuar në fund të ushtrimit. Drejtimi mendon se të drejtat e furnitorëve dhe llogarive të tjera të pagueshme janë paraqitur me vlerën e tyre reale.

Të pagueshme ndaj punonjësve dhe sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore janë paraqitur detyrimet e mbetura pa u paguar për periudhën Dhjetor 2020.

Në "Të tjera" janë paraqitur detyrime të krijuara në ushtrimet e kaluara por nuk është likjuar pasi nuk është kuadruar me kreditorin. Në të ardhmen drejtimi, pasi ti rivlerësojë do ti kalojë në aktivet neto të pakufizuara.

8. Të ardhurat

Të ardhurat e realizuara gjatë ushtrimit sipas burimit (kategorive) të tyre paraqiten si vijon:

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2020	Viti Paraardhës 31.12.2019
	Të ardhurat		
1	Të ardhura nga tarifat e antarësimit	1,885,722	1,959,600
2	Të ardhura nga donacionet dhe kontributet vullnetare	-	-
	Donacion në mjete monetare	-	-
	Donacion në natyrë,kohe televizive, qera etj	-	-
3	Të ardhura nga grantet qeveritare etj.	7,447,475	10,107,290
4	Të ardhura nga investimet apo dhurimet	-	-
5	Tarifat për shërbimet	-	-
6	Të ardhura nga aktivitetet tregtare	-	-
7	Të ardhura të tjera	-	-
	Shuma	9,333,197	12,066,890

Në "Të ardhura nga tarifat e antarësimit" janë pasqyruar shumat realizuar nga kuotizacionet e antarësisë të arkëtuara gjatë vitit 2020.



Në "Të ardhura nga grantet qeveritare apo nga agjenci të tjera të financimit" janë përfshirë të gjitha financimet neto buxhetore të marra nga 1 Janari deri në 31 Dhjetor 2020. Shumës totale të financuar nga buxheti prej 7.447.475 lekë.

9. Shpenzime për aktivitetet

a) Shpenzimet vjetore sipas natyrës

Shpenzimet për aktivitetet përbëhen nga shërbime e materiale të konsumuara gjatë ushtrimit, shpenzimet e personelit për pagat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore dhe nga shpenzime të tjera të funksionimit.

Shpenzimet e aktivitetit vjetor sipas natyrës së tyre paraqiten në tabelen vijuese.

Nr	Përshkrimi i Elementëve	Viti Raportues 31.12.2020	Viti Paraardhës 31.12.2019
1	Materiale të konsumueshme		
	Shpenzime të tjera, materiale promocionale	-	-
	Energji elektrike dhe uje	(356,973)	(362,026)
2	Shpenzime personeli		
	Paga dhe shperblime	(5,951,816)	(4,728,552)
	Shpenzime për sigurime shoqërore dhe shëndetësore	(889,340)	(789,669)
3	Shpenzime konsumi dhe amortizimi	(502,429)	(582,023)
4	Shpenzime të tjera		
	Qera Ambjenti	(80,750)	(301,084)
	Mirembajtje dhe riparime	(73,500)	(273,000)
	Shpenzime për Shërbime Financiare	-	(240,000)
	Printime	(203,820)	-
	Foni, Ndricim, Video, Ekran, Regji	-	-
	Baner dhe Konstruksione Skenike	(118,021)	(72,929)
	Kancelari	(38,100)	(3,000)
	Dhurata për të tretë	(1,390,700)	(223,500)
	Sherbim Katering	(127,400)	(217,940)
	Sherbime Ligjore	-	-
	Abonime Periodike	(14,040)	(12,000)
	Materiale për zyren	(94,961)	(70,780)
	Sherbime Informatike	-	(44,872)
	Karburant	-	(480,000)
	Sherbime Sigurimi	(19,914)	(19,700)
	Transferime, Udhetime	(32,887)	-
	Spensime Telefoni Albtelekom	(69,600)	(69,600)
	Dergime SMS	-	-
	Te tjera	(16,261)	(13,061)



5 Te ardhura dhe shpenzime financiare (interesa, dif. kursi etj.)	(14,847)	(13,453)
TOTALI I SHPENZIMEVE	(9,995,359)	(8,517,189)

b) Shpenzimet e vitit raportues ndarë sipas aktiviteteve

Gjatë ushtrimit 2020, janë evidentuar dhe raportohen vetëm shpenzime të aktivitetit normal të funksionimit të partisë, pasi nuk ka patur aktivitete të tjera.

10. Aktivët Neto

Aktivët neto të Partisë Drejtësi, Integrim dhe Unitet në fund të vitit 2020 janë 23,834,387 lekë dhe janë aktive neto të pakufizuara. Ndërsa ndryshimi i aktivitetit neto për vitin 2020 që rezulton nga diferenca midis të ardhurave dhe shpenzimeve është në shumën (662,162) lekë.

SHENIME TE TJERA SHPJEGUESE

11. Ngjarjet pas datës së pasqyrave financiare

Asnjë ngjarje e rëndësishme nuk ka ndodhur pas datës së miratimit të pasqyrave financiare.

12. Shifrat krahasuese

Pasqyrat financiare të vitit 2020 janë hartuar dhe paraqitur në përputhje me formatet që janë dhenë në shtojcën e standardit për OJF (SKK-të e përmirësuara).

